British Embassy
Pristina

UN WOMEN

KODI I NADIA MURAD

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës
Association of Journalists of Kosovo

KODI I NADIA MURAD

Nadia Murad është një grua Yazidi, e mbijetuar e dhunës seksuale në Irak dhe fituese e Çmimit Nobel për Paqe për punën e saj në avokimin për të drejtat e të mbijetuarve të dhunës seksuale dhe gjenocidit.

Kodi i Nadia Murad është një grumbull udhëzimesh për të ndihmuar bashkësinë ndërkombëtare që të adresojë dhe parandalojë dhunën seksuale në konflikt, duke u kujdesur për të ofruar më shumë mbështetje dhe mbrojtje për të mbijetuarit. Ky kod u përpilua nga Nadia Murad dhe një tjetër fitues i Çmimit Nobel për Paqe, Denis Mukëege, dhe ishte përgjigje për krimet e kryera nga ISIS kundër vajzave dhe grave Yazidi, por përtej kësaj për të luftuar dhunën seksuale nga të përdorurit si mjet lufte.

Kodi Murad shërben si një udhëzues praktik dhe moral, që e nxitë bashkësinë ndërkombëtare të përpilojë politika më të forta dhe të nxjerrë rezultate konkrete për të eliminuar dhunën seksuale në zona konflikti.

Qëllim i rëndësishëm është fundi i pandëshkueshmërisë për autorët e dhunës seksuale, duke e vënë thekstin aty në përpjekjen që ky lloj krimi të njihet si "krim ndërkombëtar".

Përtej sjelljes në skenë të dhimbjes dhe traumës së të mbijeturave të dhunës seksuale, Kodi synon të arrijë ndryshime rrënjësore për mënyrën se si komuniteti ndërkombëtar e trajton dhe përgjigjet ndaj rasteve të dhunës seksuale në konflikt.

Elemenetet kryesore të Kodit Murad janë:

Kodi vë në theks vendosjen e nevojave, dinjitetit dhe të drejtave të mbijetuarve në plan të parë. Avokon për rëndësinë e respektimit të zërit të të mbijeturëve në të gjitha aspektet.
Një parim qendror është rëndësia e mbajtjes përgjegjës të autorëve të dhunës seksuale. Kjo përfshin edhe kërkesën që sistemi ligjor ndërkombëtar, duke përfshirë Gjykata Ndërkombëtare e Krimeve (ICC) të hetonë dhe dënonë ata që janë përgjegjës për dhunën seksuale në konflikt .
Kodi nënvizon nevojën për përpjekjet për parandalim, duke përfshirë programe edukimi dhe ndërgjegjësimi, për të adresuar rrënjët e dhunës seksuale në konflikt dhe për të sfiduar normat sociale që mundësojnë një dhunë të tillë.
Kodi Murad bën thirrje që të mbijetuarit të kenë qasje të papenguar në drejtësi, duke u siguruar që mund të kërkojnë dhe marrin mbështetje ligjore pa frikën për stigmatizim apo hakmarrje.

Të mbijetuarit duhet të kenë qasje të gjerë në shëndetësi, mbështetje psikologjike, ndihmë ligjore dhe strehim të sigurtë. Kjo qasje siguron që të mbijetuarit e dhunës seksuale të marrin kujdesin dhe mundësitë për rikuperim.
Kodi Murad avokon për përfshirje aktive të komuniteteve, sidomos liderëve lokalë dhe institucioneve, në parandalimin e dhunës seksuale dhe kujdeset që ata të jenë në gjendje të ndihmojnë të mbijetuarit.
Kodi kërkon vullnet global politik dhe përpjekje të koordinuara mes qeverive, organizatave ndërkombëtare, dhe shoqërisë civile për të krijuar një sistem që parandalon dhunën seksuale dhe u përgjigjet në mënyrë efektive nevojave të të mbijeturëve.